



Data: 22.02.2019

Ref.: 312/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

## V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e BPrAL Kolegji "Pjetër Budi" (Nr.1488/18H, datë 31.10.2018) për akreditim/riakreditim të programeve të studimit si më poshtë:

- Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS (me specializime: Menaxhimi i Resurseve Njerëzore; Administratë Publike, dhe Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë).
- Juridik, LLB, 240 ECTS, (me specializime: E drejta penale, E drejta civile, E drejta administrative/kushtetuese, dhe E Drejta Ndërkombëtare), dhe
- Produksion, Film dhe Media, BA, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Pjetër Budi" ka parashtruar kërkesë (Nr.1488/18H, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditim të programeve të studimit si në vijim: Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS; Juridik, LLB, 240 ECTS, dhe Produksion, Film dhe Media, BA, 180 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KSHC në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Pjetër Budi", dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, sipas së cilit: *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit*



përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”, KShC erdhi në përfundim se programet e studimit: Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS; Juridik, LLB, 240 ECTS, dhe Produksion, Film dhe Media, BA, 180 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim të aplikacionit.

Bazuar në nenin e referuar më sipër KSHC ka verifikuar te gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit. Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KSHC-së të mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KSHC mori vendim që të refuzoj aprovimin e aplikacioneve të BPrAL Kolegji “Pjetër Budi”, sipas pikës një të dispozitivit të këtij vendimi.

1. Për programin e studimit: *Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS*, (me specializime: Menaxhimi i Resurseve Njerëzore; Administratë Publike, dhe Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë), si bartës të këtij programi Kolegji “Pjetër Budi”, ka paraparë këta persona: Petrit Nimani (PhD në Biznes, Administrative, Komunikimet Shoqërore dhe Teknologjitë), Feim Blakqorri, dhe Fitim Macani.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Pjetër Budi, duhet te ketë te paktën tre staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji “Pjetër Budi” për këtë program të studimit, u konstatua se nuk ka staf akademik me dokumentacion te rregullt sipas dispozitave ligjore ne fuqi. Feim Blakqorri, nuk ka nostrifikim te diplomës nga MASHT, siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: *“për qellim të punësimit, këto diploma duhet të nostrifikohen nga MASHT”.* Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës se studimeve te doktoratës, i njëjti nuk mund të pranohet si bartës i këtij programi të studimit. Ndërsa Fitim Maçani, ka gradën shkencore MA, e jo PhD siç kërkohet me nenin 26, pika 5.3.4. Mbi këtë bazë i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi, pasi që nuk plotëson kushtet ligjore.

Andaj, bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit me gradën PhD sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KShC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS*, (me specializime: Menaxhimi i Resurseve Njerëzore; Administratë Publike, dhe Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë).



2. Për programin e studimit: *Juridik, LLB, 240 ECTS, (me specializime: E drejta penale, E drejta civile, E drejta administrative/kushtetuese, dhe E Drejta Ndërkombëtare)*, si bartës të këtij programi Kolegji "Pjetër Budi", ka paraparë këta persona: Orhan Çeku (PhD në Siguri Kombetare), Toshe Panov (N, F, R), Elizabeta Spiroska (D, R, F, ID), Jana Ilieva (D, N, R, F, ID), Zvonimir Jankulloski (R, F), Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Pjetër Budi, duhet të ketë të paktën katër anëtarë të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Jana Ilieva nuk mund të pranohet si e tillë, pasi që nuk ka nostrifikim të diplomës nga MASHT, siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi.

N[ Udhëzimin Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: *"për qëllim të punësimit, këto diploma duhet të nostrifikohen nga MASHT"*. Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës së studimeve të doktoratës, e njëjta nuk mund të pranohet si bartëse e këtij programi të studimit. Përveç kësaj, e njëjta nuk do dorëzuar as diplomën e kualifikimit, leje-qëndrimin e Republikës së Kosovës, dhe konfirmimin se e njëjta nuk ka marrëdhënie të rregullt të punës në Maqedoni. Në mungesë të dokumentacionit relevant, e njëjta nuk mund të pranohet si bartëse e programit Juridik.

Toshe Panov nuk mund të pranohet si staf akademik, pasi që i njëjti nuk ka nostrifikim të diplomës nga MASHT, siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: *"për qëllim të punësimit, këto diploma duhet të nostrifikohen nga MASHT"*. Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës së studimeve të doktoratës, i njëjti nuk mund të pranohet si bartës i këtij programi të studimit.

Gjithashtu edhe stafi tjetër Jana Ilieva nuk mund të pranohet si staf akademik, pasi që e njëjta nuk ka nostrifikim të diplomës nga MASHT, siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: *"për qëllim të punësimit, këto diploma duhet të nostrifikohen nga MASHT"*. Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës së studimeve të doktoratës, e njëjta nuk mund të pranohet si bartëse e këtij programi të studimit.



Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit me gradën PhD sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KShC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Juridik, LLB, 240 ECTS, (me specializime: E drejta penale, E drejta civile, E drejta administrative/kushtetuese, dhe E Drejta Ndërkombëtare)*.

3. Për programin e studimit: *Produksion, Film dhe Media, BA, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji "Pjetër Budi", ka paraparë këta persona: Mark Norfolk, Makfire Miftari, Ekrem Sopi, Imer Mushkolaj, dhe Faton Bajraktari.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

*Meqenëse këto programe kualifikohen si programe te arteve, sipas UA (nr.02/2019, datë 31.01.2019) për ndryshimin dhe plotësimin e UA për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), kërkohet që IAL-të të kenë staf me tituj të barasvlershëm artistik.*

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, dhe pika një (1) e nenit 2 e UA (nr.02/2019, datë 31.01.2019) për ndryshimin dhe plotësimin e UA për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), për këtë program të studimit Kolegji Pjetër Budi, duhet të ketë të paktën tre anëtarë të stafit akademik të paktën me gradën shkencore MA apo të barasvlershëm, me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.


Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji "Pjetër Budi" për këtë program të studimit, u konstatua që: **Mark Norfolk** nuk mund të pranohet si staf akademik, pasi që i njëjti nuk ka nostrifikim të diplomës nga MASHT, siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: *"për qellim të punësimit, këto diploma duhet të nostrifikohen nga MASHT"*. Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës së studimeve të doktoratës, i njëjti nuk mund të pranohet si bartës i këtij programi të studimit. Ekrem Sopi nuk ka dorëzuar asnjë dokument në AKA, dhe si i tillë nuk mund të pranohet si bartës i programit, pasi që nuk mund të konfirmohet kualifikimi dhe fusha e tij e studimit. Ndërsa Imer Mushkolaj është MA i Resurseve Njerëzore, fushë kjo e cila nuk i përket fushës së programit të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, dhe pika një (1) e nenit 2 e UA (nr.02/2019, datë 31.01.2019) për ndryshimin dhe plotësimin e UA për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Fotografi, BA, 180 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Pjeter Budi";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

